Kronikë

Vrasje në Fier/ 41 vjeçari ekzekutohet sapo zbret nga makina! Identifikohet dorasi! Foto ekskluzive të autorit dhe makinës me të cilën u largua! (EMRAT)

Qyteti i Fierit u trondit paraditen e sotme. Viktima, i identifikuar si Elton Javori, 41 vjeç banues i këtij qyteti, u ekzekutua reth orës 11:00 teksa zbriste nga makina e tij Porsche Cayenne pak metra larg banesës së tij në lagjen '16 prilli' në Fier.

- Ekskluzive/ Foto e makinës me të cilën u largua autori i vrasjes së Elton Javorit
- VIDEO/ I rrethuar e shirit, pamjet e para pas vrasjes
- U qëllua me pistoletë, Report Tv zbardh motivin e dyshuar
- Dëshmia e fqinjit: Dola me vrap sapo dëgjova të shtënat...
- VIDEO/ Vrasja e 41 vjeçarit në Fier, autori dyshohet të jetë larguar drejt Vlorës! Policia 'blindon' qytetin bregdetar
- Ekzekutimi, ja çfarë deklaron policia

Redaksia
7 Dhjetor, 11:18 | **Përditesimi: 7 Dhjetor, 13:48**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Fier- Një 41 vjeçar u ekzekutua sot paradite në qytetin e Fierit. Viktima, i identifikuar si Elton Javori, 41 vjeç banues i këtij qyteti, u ekzekutua reth orës 11:00 teksa zbriste nga makina e tij Porsche Cayenne pak metra larg banesës së tij në lagjen '16 prilli' në Fier.

Autori është identifikuar si Agim (Agli) Gashi, 35 vjeç i cili është larguar me një makinë tip Benz ngjyrë gri. Report Tv solli foto ekskluzive të autorit dhe makinës me të cilën dyshohet se është larguar.

Dyshohet se vrasja ka ndodhur kur viktima ka zbritur nga makina, gati 100 metra afër banesës ku jetonte. Report Tv sjell pamjet e para nga vendngjarja, policia rrethoi zonën me shirit ndërsa ekspertë të policisë në vendin e ngjarjes punojnë për mbledhjen e provave.

Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se viktima është vrarë me pistoletë për motive të dobëta, një krushqi e prishur, informon gazetari i Report Tv, Sokol Dema.

LEXO EDHE:
Librazhdi, Saranda dhe Fieri ndriçohen për festat e fundvitit! Drita, fishekzjarre dhe muzikë (VIDEO)

Elton Javori rezulton të jetë nipi i Medi dhe Demir Backës, të vrarë në vitet 1997 dhe në 2021. Medi Backa, i njohur si anëtar i bandës së Fierit u vra në 1997 në Masakrën e Levanit.

Janë ngritur pika kontrolli në çdo aks rrugor, si dhe vijon intensivisht krehja e zonës. Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe kapjen e autorit

Në zhvillimet më poshtë gjeni lajmet më të fundit lidhur me ngjarjen e rëndë

Lajmi ne perditesim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:17

Ekzekutoi Elton Javorin dhe u largua nga vendngjarja, ky është autori i vrasjes në Fier (EMRI+FOTO)

Report Tv ka siguruar foton e Agim Gashit, autorit të vrasjes së 41 vjeçarit Elton Javori paraditen e sotme në lagjen "16 prilli" të Fierit. Policia vijon kontrollet në akse të ndryshme të vendit për të bërë të mundur kapjen e 35 vjeçarit i cili u largua menjëherë pasi ekzekutoi me armë zjarri Javorin.

B.V/Shqiptarja.com

Share

Ora 12:57

Ekskluzive/ Foto e makinës me të cilën u largua autori i vrasjes së Elton Javorit

Gazetari i Report Tv, Sokol Dema siguron foto të makinës me të cilën u largua autori i vrasjes së Elton Javorit. Vrasja ndodhi rreth orës 11:00 në lagjen '16 prilli' në Fier.

Makina është tip benz "E class coupe' me targa shqiptare e prodhimit pas vitit 2011 me ngjyrë të errët. Vlera në treg e kësaj makine është 12- 15 mijë euro

Policia thotë se ka identifikuar autorin dhe po punon për arrestimin e tij

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 12:05

Vrasja e Elton Javorit në Fier, burime për Report Tv: U qëllua me pistoletë pas një krushqie të prishur

Detaje të reja lidhur me vrasjen e ndodhur në lagjen "16 prilli' në qytetin e Fierit. Report Tv mëson nga burime nga grupi hetimor se ngjarja dyshohet se ka ndodhur për motive të dobëta

41 vjeçari dyshohet se u vra me pistoletë pas një krushqie të prishur.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:53

'Dola me vrap sapo dëgjova të shtënat', flasin fqinjët pas vrasjes së Elton Javorit në lagjen '16 prilli' të Fierit

Një prej banorëve të lagjes "16 prilli" në Fier ka folur për mediat pas vrasjes së 41 vjeçarit Elton Javori në Fier. Ai tha se i ndjeri banonte 100 metra larg vendit ku mbeti i vrarë.

Ndërsa zbulon se në momentin që dëgjoi krismat doli me shpejtësi nga kafja ku po hynte.

> *"Ka qenë djalë i mrekullueshëm, i edukuar dhe i sjellshëm. Ka babanë e nënën këtu, vëllezërit i ka në Gjermani. Nga erdhi kjo, Zoti e di. Sa dola nga shtëpia, u futa të pija kafe, dola me vrap"- u shpreh banori.*

B.V/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:40

Vrasja në Fier, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë: Kemi identifikuar autorin

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Muhamet Rrumbullaku deklaroi se autori është identifikuar dhe po punohet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

> *Kemi marrë njoftim, aktualisht grupi hetimor po kryen veprimet. Janë marrë masat për kapjen, e kemi të identifikuar, po punohet për sqarimin e rrethanave që kanë çuar në këtë krim të rëndë" tha Rrumbullaku në një konferencë për median mbi rezultatet e megaoperacionit kombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", për goditjen e rasteve të organizimit të kundërligjshëm të lojërave të fatit.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:40

VIDEO/ Vrasja e 41 vjeçarit në Fier, autori dyshohet të jetë larguar drejt Vlorës! Policia 'blindon' qytetin bregdetar

Policia e Vlorës ka ngritur postoblloqe në hyrje të autostradës për kapjen e autorit të vrasjes së 41 vjeçarit Erjon Javori në lagjen "16 prilli" të Fierit.

Mësohet se autori i ngjarjes është identifikuar nga policia dhe për kapjen e tij janë ngritur pika kontrolle në zona të ndryshme. Deri më tani dihet se autori është banues në Fier.

B.V/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:24

Ekzekutohet 41 vjeçari në Fier, ja çfarë deklaron policia

Policia jep informacion lidhur me vrasjen në Fier. Viktima është Elton Javori.

> *Fier/Informacion paraprak*
>
> *Rreth orës 11:00, në lagjen "16 prilli", është vrarë me armë zjarri shtetasi E. J., 41 vjeç, banues në Fier.*
>
> *Shërbimet e Policisë, sapo kanë marrë njoftim, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, kanë identifikuar autorin dhe po punojnë për kapjen e tij.*
>
> *Janë ngritur pika kontrolli në çdo aks rrugor, si dhe vijon intensivisht krehja e zonës.*
>
> *Ndërkaq, grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe kapjen e autorit.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/Shqiptarja.com

TAG: elton javori Fier

Komento

Komente

Fieri: 07/12/2023 13:58

Problematik kan qen te dy motivi dihet ca folni kot

Përgjigju

Gjynah: 07/12/2023 13:50

Mos befsh hajer gjith jeten qe vret nje djal te ri pa faj per ceshtje banale

Përgjigju

Ndergjegja: 07/12/2023 13:43

Prelud i dites se 8 dhjetorit salehut dhe kongresit te edvinit.....

Përgjigju

Pabuksi: 07/12/2023 13:34

Alamet makinet

Përgjigju

Biku: 07/12/2023 12:09

Kot beni postoblloqe. Te gryka e semanit do e keni duke hip ne skaf

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:
A duhet të marrë fund kaosi në kuvend?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Fier, sherr mes vëllezërish në lagjen "Sheq i Madh'

6 Dhjetor, 16:39

Në Spitalin Memorial të Fierit kryhet ndërhyrja tek Pacientja që vuante nga çrregullimi gjenetik 'Trisomia 21'

6 Dhjetor, 12:27

Vrasja e Liridonës, marshim në Shkodër e Fier! Qytetarët bashkë për t'i thënë "ndal" dhunës ndaj grave: Përgjegjësi të edukojmë fëmijët, djemtë e vajzat

Ergys Kavaja

Kristaq Thano

5 Dhjetor, 17:22

Video/ 3-vjeçarja vetëm në shtëpi, në katin e pestë në Fier! Të qarat alarmojnë fqinjët, zjarrfikësit me shkallë hyjnë nga dritarja

5 Dhjetor, 14:21

'Sundimi i ligjit'/ Nga vjedhja te thyerja e masës 'arrest në shtëpi', tre të arrestuar në Fier

5 Dhjetor, 09:54

Nuk arrestonte shpërndarësit e drogës, pezullohet nga detyra nënkomisari Taulant Ismailaj në Fier! I ndalohet edhe dalja jashtë vendit

4 Dhjetor, 18:09

VIDEO/ Aksident në aksin Fier-Patos, 'Benz'-i përplaset me autobusin e mbushur me nxënës

4 Dhjetor, 09:02

'Kapriçiot' e motit dëmtojnë pataten e vjeshtës në fushat e Divjakës, fermerët: E shesim me 45 lek/kg, nuk mbulojmë sot as koston

Yrjet Saliasi

3 Dhjetor, 16:19

Raporti/ Mbi 365 hektarë me pisha u dogjën në zonën e mbrojtur të Pish Poro-Nartë

1 Dhjetor, 15:00

SPAK mbyll hetimet për laboratorin e kokainës në Frakull të Fierit pritet dosjen ta çojë në gjykatë! Indicie dhe për emra të tjerë

Keti Banushi

1 Dhjetor, 09:44

Zjarri pranë azilit në Fier, të moshuarit rrëfejnë tmerrin: Tymi ishte si vullkan! Ishim me fat që nuk ra natën

Kristaq Thano

30 Nëntor, 11:51

Përfshihet nga flakët kabina elektrike në Fier, shkak ngarkesa në rrjet! Dhjetëra familje në errësirë

29 Nëntor, 18:11

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje